



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3128 Prot.

Roskovec, më 01.07 2020

VENDIM

NR 40 .DATË 29 .06 .2020

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN MAJ 2020”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 29.05.2020, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Maj 2020.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al

Nr. 2409/1 Prot.

Roskovec, më 02.06.2020

Procesverbal Nr.5

-I mbajtur sot, date 29.05.2020, ora 11, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes. Mbledhja e sotme po zhvillohet ne sallen e madhe te Pallatit te Kultures, e cila ka hapsire te mjaftueshme per ruajtjen e distances se keshilltareve, ne zbatim edhe me vendimet e qeverise. Keshilltaret jane paraqitur me maska dhe dorashka. Rendi i dites se mbledhjes:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Prill 2020.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Prill 2020.
5. Për shpronësimin për interes publik, të pasurive të paluajshme pronë private, që preken nga projekti “Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin e Roskovecit”
6. Për miratim dhe transferim fondesh në Buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2020.
7. Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2019.
8. Rregullore për funksionimin e tregut publik.
9. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes se mbledhjes: 11⁰⁰

Keshilltaret prezent ne hapjen e mbledhjes: A.Kola, K.Kuka, V.Mata, E.Çepele, Rr.Hazizi, L.Hoxha, L.Goga, B.Çobo, B.Kuka, T.Kuka, K.Hyska, A.Hazizi, V.Bakaj, V.Dogani, A.Sheme, H.Beqiraj, B.Toska, M.Sufka.

Keshilltaret qe mungojne : Mungojne ne mbledhje D.Hoxha, G.Hoxha, V.Stani.

Te pranishem nga administrata e bashkise: Kryetarja e Bashkise, Dr.Juridike, Dr.Finances, P/Z/Tatim-taksave, Sp.Uranistikes, P/Sherbimeve, P/Z/Ndihmes Ekonomike, Nenkryetari, Sp.bordit te kullimit.

Me plotesimin e kuorumit, kryetari i keshillit hap mbledhjen. Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 18 keshilltare.

Para se te filloje me rendin e dites, kryetari ben me dije se na kane ardhur dy projekt-vendime shtese nga administrata e bashkise: “Per perjashtimin nga tarifa e urbanistikes te fermereve qe do te ndertojne ure auto tip per kalim mbi kanalet kullues”, “Per miratimin e projektit me objekt

“Ndertim Ure-Auto Tip qe do te zbatojne fermeret per kalimet mbi kanalet kulluese K-34 Suk,2-Kolektor,K-26 Jagodine-Suk”.Hidhen ne votim per ti futur shtese dhe miratohen unanimisht me 18 vota pro ti fusin ne rendin e dites.

1.Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Kryetari i Keshillit hedh ne votim rendin e dites bashke me dy projekt-vendimet qe futen shtese si me siper dhe miratohet unanimisht me 18 vota pro rendi i dites.

2.Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Prill 2020.

Sekretarja e keshillit sqaron shkresen e ardhur nga Prefektura ne lidhje me aktet normative.Sqaron se kemi filluar qe nga muaji i kaluar qe ne Prefektore do dergojme vetem aktet normative,aktet individuale dhe kolektive nuk do te dergohen ne Prefektore.

3.Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Elmazi-nuk duhet te na vijne materialet me vonese dhe mos te kete material shtese ditin e mbledhjes-ankese dhe vrejte ne grup.Kryetarja e Bashkise-e para eshte verejtje me vend,per te dyten ndodh qe del nje problem dhe na kushton shume ne kohe nese do i lem per ne mbledhjen tjeter.Sekretarja sqaron procesverbalin e mbledhjes se kaluar.Hidhet ne votim dhe miratohet unanimisht me 18 vota pro procesverbalit i mbledhjes se kaluar.

4.Per dhenien e Ndhimes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-30 Prill 2020.

Elmazi-si grup doli te shtrihet me shume ne baze skema,nese ka mundesi qe personat ne fjale aplikojne por nuk perfitojne,zyra perkatese duhet te zbresi sa me shume ne baze.Leksi-aty eshte nje formular tip qe nuk levizin dot nga korniza,formularin tip e plotesojne te gjitha pastaj vijne 4-5 emra.Elisi P/Z/NE sqaron kriteret sesi perzgjidhen emrat ne sistem.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 18 vota pro projektvendimi i 6%.

5.Per shpronësimin per interes publik,te pasurive te paluajtshme prone private,qe preket nga projekti “Permiresimi i furnizimit me uje te pijshem per qytetin e Roskovecit”.

Dr.Juridike Delina Hoxha sqaron projektin e shpronësimit nga projekti “Permiresimi i furnizimit me uje te pijshem per qytetin Roskovec”Sqaron se qytetaret qe jane ne liste preken nga ky projekt dhe do te shpronësohen sipas percaktimeve ligjore.Sqaron edhe vlerat perkatese te tokes are dhe kultures bujqesore.Elmazi-si grup jemi dakort.Sqarohet se eshte bere takimi me qytetaret dhe jane dakort me shpronësimet.Hidhet ne votim projekti i shpronësimit sipas listes dhe materialit te paraqitur per D.Hoxha,H.Mamo,A.Hoxha+E.Hoxha dhe miratohet unanimisht me 18 vota pro (3/5 +5) vota pro.

6.Per miratim dhe transferim fondesh ne Buxhetin e Bashkise Roskovec per vitin 2020.

Dr.Finances sqaron se pika e pare ke te bej me ate qe sapo miratuat shpronësimin.Pika e dyte ka te bej me hapjen e nje pus-shpimi studimor per permiresimin me uje te pijshem ne lagjen Agaçe.Pas ardhjes se materialeve te plota por pak me vonese,shifra ndryshon nga ajo qe ju ka ardhur juve.Kryetarja sqaron se burimi qe ekziston eshte i pamjaftueshem qe furnizon dy fshatra.Ne kemi menduar te hapim nje pus qe te furnizoj keto dy lagje Agaçaj dhe Metushaj.Per te bere nje pus definitive duhet te bejme nje pus paraprak studimor per te pare nese ne kete zone ka uje te mjaftueshem dhe a eshte i pijshem?Nese do jete ai qe ne presim,keto dy lagje do te marin uje nga ky pus.Me informacionet qe kemi ne nga sherbimi gjeologjik shqiptar kohe me pare aty ka qene nje pus.Kete pus studimor duhet ta bejme sa me shpejt sepse zgjidh nje hall shume te madh te banoreve te ketyre lagjeve.Fillimisht na u tha se vlere mund te shkonte 300,000 leke,por me vone kur na erdhen dokumentat dje,ndryshonte vlere ne 549,955 leke prandaj duhet ta kalojme me kete vlere.Leksi-ata duhet ta kene nje far koncepti nese ka uje apo jo.Bujari-po ky pus mbetet

funksionar me vone?Kryetarja sqaron se kjo do te shihet pas studimit qe do te behet.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimitisht me 18 vota pro projekti bashke me vleren e ndryshuar ne piken 2 dhe miratohet unanimitisht me 18 vota pro.

7.Per miratimin e raportit vjetor te konsoliduar te zbatimit te buxhetit te vitit 2019.

Dr.Finances sqaron se ky projekt eshte detyrim ligjor per tu miratuar.Nuk ka pyetje per projektin.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimitisht me 18 vota pro.

8.Miratimi i Rregullores per funksionimin e tregut publik ne Bashkine Roskovec.

Elmazi-e diskutuam ne grup,ky material te kishte ardhur ne kohe.E dime qe ju u takuat edhe me grupet e biznesit dhe interesit.Nje tregtar te paguaj 12 mije leke eshte e veshtire ne kete suate.Shperndarja e tregut nga rotondoja deri te Meti duhet te jete pa mjete,ndersa nga rotondoja deri tek kandari te jete me makina.Une jam per ti ndihmuar qytetaret.Ti lem 2-3 te Djela te lihen tregtaret te lire ti ndihmojme.Leksi-kerkon nje sqarim per rregulloren e funksionimit te tregut,ku do shtrihet tregu?Kryetarja sqaron se kemi patur shume diskutime edhe me tregtaret,tregu eshte tradite dhe frymemarrje per qytetaret.Sot ka donacione qe nese marim keto vendime,mund te arrijme gjera shume te mira per financimin dhe rregullimin e ketij tregu.Investimet sapo jane kryer,nese tregtaret prishin trotuarin,pemet etj do te kete edhe penalitete sepse sapo u bene investimet.Ne ju kemi sjelle propozim kete projekt,modelin e kemi mar nga tregu i Tiranes.Ne rregullore jane percaktuar oraret 4-6 sillet malli me makine,6-1 behet pazari etj,kemi percaktuar edhe grupet dhe ndarjet e tregtareve.Ka qytetare qe ditën e Djele e duan pushim dhe qetesi.Kemi percaktuar orarin,grupimin,levizjen e makinave,rrugen e cila do te jete e lire,ndalimet se cfare nuk i lejohet tregtareve,penalizimet,mirmbajtja dhe demtimet.Ne jemi duke pergatitur nje pakete me masa ndeshkuese edhe per tragtaret gjate javes si dhe per qytetaret.Do lejohen aktivitetet por ne baze te rregullave,do filloje ndeshkimi pas pergatitjes se paketave ndeshkuese.Drejtoria e te ardhurave dhe policia bashkiake do zbatojne vendimin.Rruget qe kane hapsire te jene per tregtaret me makina,rruga nga vajza myzeqare deri tek rrethrotullimi tek gjimnazi.Rruga nga gjimnazi deri tek bashkia,zbret poshte tek Ferati dhe qendra rinore eshte per tregtaret qe nuk tregtojne ushqime.Do te zihet vetem nje ane e rruges.Nga trekeneshi dhe deri tek rruga e Kurjanit do te jete per ushqimore sic ka qene,nga trekendeshi dhe lart tek pasticeri tradicional do jete pa makina.Tregu i shpendeve dhe tregu i peshkut ku ka qene.Kemi patur ankesa nga tregtaret qe kane dyqane fikse ne lidhje me shitesit ambulant,e kemi menduar 3 me 3 per tregtaret ambulant,dyqanet duhet te kene hapsire dhe 2 m rruge kalimi qe te kene mundesi te komunikojne.Hapsira per makinat eshte 6 me 5.Do perpiqemi ta monitorojme mire kete pune,tregtari do mari planvendosje ne bashki.Tarifa do te jete 50 leke m2 sipas asaj qe eshte miratuar ne keshill.Ata me makina nje do paguajne.Nese sjeni dakort,atehere hapim fushen e sportit per parkimin e makinave me pagese.Elmazi-tek rregullorja skam asnje verejtje,jane rregulla qe duhet te zbatohen.Leksi-Shtrirja ka vetem disa ndryshime te vogla,me investimet qe jane bere duhet te zbatohen rregullat.Persa I perket dites se pazarit ai duhet bere sepse eshte tredite dhe frymemarrje,nga kryqezimi deri tek Tani Çanta pa u shkeputur hallka e tyre.Leksi-ka sugjerim per ambulantet dhe dyqanet,mendoj sikur te jene balle per balle ambulanti me dyqanin,tarifa-sikur tua ulim aq sa na lejon ligji 30%,te shikohet tarifa me 30% ulje.Kryetarja sqaron se ne lidhje me shtrirjen e diskutuam me bizneset dhe nuk na e dhane ate opsion,ata jane dakort me propozimin tone.Ne lidhje me ambulantet dhe dyqanet kjo edhe mund te rregullohet.Ne lidhje me tarifen 30% ulje une dakort jam,por do jemi shume strikt me siparfaqen,nuk do tolerohet asnje per vendin qe ze.Ambulanti pa nipt nuk paguan asgje,ata me nipt sigurime shoqerore,ai qe ka dyqan paguan shume taksa ne bashki.Duhet te marim nje vendim qe as mos ti rendojme.Tajane-nuk eshte njelloj si ai qe i paguan te gjitha taksat dhe ai

qe nuk paguan asgje. Ne parim duhet te jene te gjithë njelloj. Krijohen papasterti, zhurme, ze hapsiren, nuk me duket e drejte tja ulim tarifen. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 18 vota pro rregullorja e funksionimit te tregut publik ne Bashkine Roskovec. Do te jete drejtoria e te ardhurave dhe policia bashkiake qe do zbatoje kete vendim.

9. Per perjashtimin nga tarifa e urbanistikes te fermereve qe do te ndertojne Ure Auto Tip per kalim mbi kanalet kulluese.

Irena Blea sp. urbanistikes sqaron projektin, te cilat jane ura funksionale por jane prishur dhe do te ndertohen prape keto ura. Kemi menduar qe te perjashtohen nga tarifa e urbanistikes per fermeret qe do te ndertojne ure-auto per kalim mbi kanalet kulluese. Ata do te kene mundesine ta rindertojne uren sipas modelit qe kemi propozuar ne dhe do ti perjashtojme nga tarifa e urbanistikes per kete ure. Ne kete rast jane favorizuar fermeret. Cdo punim qe do kryhet duhet te mari leje ne bashki, dhe keta fermer jane perjashtuar nga kjo tarife. Bujari-edhe per uren duhet te marin leje ndertimi? Jam pak pesimist tek tarifa qe paguhet ne bashki. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 18 vota pro perjashtimi nga tarifa e urbanistikes i fermereve qe do ndertojne ure auto tip.

10. Per miratimin e projektit me objekt "Ndertim Ure-Auto Tip qe do te zbatojne fermeret per kalimet mbi kanalet kulluese K-34 Suk, 2-Kolektor, K-26 Jagodine-Suk.

Nuk ka pyetje per kete projekt sepse u diskutua me siper. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 18 vota pro projekti "Ndertim Ure-Auto Tip qe do te zbatojne fermeret per kalimet mbi kanalet kulluese sipas materialit te paraqitur.

11. Diskutime dhe komente te qytetareve.

Leksi-jam i detyruar te ngre hallet e qytetareve, kam kerkuar drejtues e oshee-se per problemin e energjise elektrike, kam kerkuar qe te vendosen gome apo shirita neper shkalle tek Alush Grepcka. Tek rruga e ish-baxhos eshte problem shpejtesia e makinave, tek pjesa e projektit bie ne sy qe jane disa pallate qe nuk jane prekur dhe sjane lyster, te jene uniforme. Tek pjesa e trotuareve cilesia e punimeve dhe materialet jane shume te dobeta. Te vij Fatjoni nga oshee-ja ne mbledhjen tjeter-porosi nga Leksi dhe kryetarja. Per Alush Grepcken problemin e shkalleve do e shohim. Fasadat e pallateve-pallatet qe jane prekur faqen e pare do plotesohen edhe faqet e tjera, pallati ne forem L nuk behet, kapaket e pusetave do te vihen me pllake guri. Alketi-problemi i ndricuesve aty ku mungojne ose jane djegur llampat. Kryetarja sqaron se sapo te blihen materialet do te zgjidhet ky problem. Bajamja-tek rruga e lagjes saj problemet e kanalizimeve, eshte hequr nje shtylle, pyet edhe per rregullimin e rruges. Kryetarja sqaron edhe ne lidhje me zyren e re te keshillit dhe zyren per mbledhjet e administrates. Duhet te mobilohen dhe sistemi i fonise, te cilat do tua sjellim mbledhjen tjeter. Viktori-ka kerkesa nga fermeret per ujin e vaditjes. Kryetarja sqaron se pa paguar detyrimin nuk do çohet uji. Viktori-per ata qe nuk i paguajne jam dakort, po per ata qe paguajne pse te penalizohen. Viktori-kanalet qe jane bere me beton i kontrollon njeri? Sepse vete nje qytetar dhe e prish me varre. Mateus-perroi qe kalon ne mes te fshatit tim, eshte shume i ndotur, derdhen plehra. Nese ka mundesi te pastrohët? Kryetarja-i kemi bere kerkesë bankes boterore se kjo nuk varet nga ne. Bujari-keni dijeni per rugen e Luarit, per investimin e ri dhe te vjeter? Kryetarja sqaron se firma solli pretendime ne bashki, u pa projekti nga bashkia dhe e derguam tek fondi shqiptar i zhvillimit. Rruga tjeter brenda gushtit do mar zgjidhje. Nuk ka me pyetje nga keshilltaret. Kryetari i keshillit i falenderon per pjesmarrjen keshilltaret dhe Kryetaren e Bashkise. Mbyllet mbledhja.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Kadri Hyska

